

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Operatori Ekonomik: GJEO – PROJEKT SH.P.K., Rr, UÇK-së, pn, 21000, Rahovec Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	25.06.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **25.06.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **GJEO – PROJEKT SH.P.K.** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DIGJITALIZIMI I DOKUMENTACIONIT KADASTRAL – RIRREGULLIMI I VEKTORIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-24-3443-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-011-2-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **GJEO – PROJEKT SH.P.K.** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DIGJITALIZIMI I DOKUMENTACIONIT KADASTRAL – RIRREGULLIMI I VEKTORIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-24-3443-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-011-2-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **21.06.2024**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-24-3443-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-011-2-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **GJEO – PROJEKT SH.P.K.** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DIGJITALIZIMI I DOKUMENTACIONIT KADASTRAL – RIRREGULLIMI I VEKTORIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-24-3443-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-011-2-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **21.06.2024**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **25.06.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik
Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

ARSYETIM:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kërkesa 5: OE te dëshmoj me dokument relevant që është i licencuar apo ka marrëveshje me një OE Institut te licencuar ne vendin ame per ofrimin e trajnimeve ne QGIS;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia 5: Operatori Ekonomik duhet të paraqes dokumentin e noterizuar apo marrëveshjen e bashkëpunimit te vulosur dhe nënshkruar;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, keni prezantuar MARRVESHJE me Kompaninë: GEOSPATIAL DATA SYSTEM, 37000 Kruševac nga Srbija, e cila nuk posedon Licencë për mbajtjen e trajnimeve ne QGIS;

Përpos kësaj marrëveshjet e tjera me kompani nga Serbia nuk lejohen që të shfrytëzohen në Kosovë, për shkak të sigurisë së të RrUOPP dhënave ashtu siç e përcakton neni 19.8 i cili thotë: Për aplikim të paragrafit 19.7 Autoritetet Kontraktuese duhet të sigurohen që pajisjet, shërbimet dhe prodhuesit e specifikuar nuk i takojnë vendeve (shteteve) për të cilat Qeveria e Kosovës ka vendosur sanksione në import/eksport, ose vendeve, prodhimet, shërbimet dhe furnizimet e të cilave konsiderohen si të pabesueshme nga ndonjëra prej organizatave/vendeve, siç janë: Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, NATO, OECD ose Shoqata Evropiane për Tregti të Lirë, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitive të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit